

Fleta e të dhënave të produktit
 Botimi 03/10/2016
 Nr. i identifikimit: 010703010050000008
 Kodi: 03.01.010
 Sika®-Waterbars

Sika®-Waterbars Yellow SH

Profile ujëndalues (waterstop) prej PVC-je për vulosjen e fugave

Përshkrimi i produktit

Sika®-Waterbars Yellow janë ujëndalues (waterstop) fleksibël me bazë PVC të plastifikuar. Ato janë të paraformuara në profile specifike që të izolojnë dhe mbrojnë fugat e konstruksionit dhe bymimit kur betonohen dhe për ndarjen e zonave ujëmbajtëse që janë hidroizoluar me membranat Sikaplan® PVC. Disponohen në shumëllojshmëri madhësish dhe llojesh në varësi të përdorimit të tyre.

Përdorimi

Sika®-Waterbars Yellow përdoren për të hidroizoluar fugat e zakonshme dhe të bymimit në struktura betoni siç janë ato në strukturat ujëmbajtëse, përfshirë rezervuarët, kanalet, impiantet e ujërave të zeza, digat, pishinat etj. Gjithashtu, ato përdoren në pjesët kundër ujit në ndërtesa përfshirë bodrumet e mëdha, parkimet nëntokësore, nënkallimet, muret detare etj.

Karakteristika / Avantazhe

- PVC e cilësisë së lartë për qëndrueshmëri afatgjatë
- I përshtatshëm për ujë me presion të lartë
- I lehtë për t'u salduar
- Disponohet në lloje dhe përmasa të ndryshme, në varesi të aplikimit

Testime

Miratime / Standarde

Sika®-Waterbars janë testuar në përputhje me:
 EN ISO 527
 DIN 53505

Veti të produktit

Forma

Ngjyra



Për fuga ndërtimi	Llojet V, AR	I verdhë
Për fuga bymimi	Llojet O, DR	I verdhë
Ujëndalues rezistent ndaj vajgurit dhe bitumit	Shiko detajet e veçanta	

Ambalazhimi

Rulona 15 m & 30 m
 Në varësi të llojit dhe madhësisë



Llojet

Përdorimet		Lloji	Gjerësia cm (±5mm)	Gjatesia e rulonit m	Trashësia nominale mm (±0,5mm)
Për fuga ndërtimi	Ujëndaluesit e vendosur në qender Instalim në qender të struktura së betonit. Kapje e lehtë me kapësen fiksuese e Sika®. Waterbars me armaturën e hekurit	V-15	15	30	2.5 - 5.0
		V-20 L	20	30	2.0 - 4.0
		V-24	24	30	2.5 - 4.0
		V-32	32	15	2.5 - 4.5
		O-20 L	20	15	2.0 - 3.5
		O-25 L	25	15	2.0
		O-32	32	15	6
		O-32 L	32	15	2.5
Fuga ndërtimi	Ujëndalues sipërfaqësorë Instalimi në sipërfaqe të strukturave të betonit	AR-20*	20	15	3.5
		AR-25*	25	15	3.5
		AR-31	31	15	4.0
Fuga bynimit		DR-21*	21	15	3.5
		DR-26*	26	15	3.5
		DR-32	32	15	4.0

Lloje ujëndaluesish specialë (disponohen sipas kërkesës):

- Sika Waterbars® PVC-P sipas DIN 18541
- Sika Waterbars® TPO/FPO
- Tricosal® Tricomer®: rezistent ndaj vajit dhe bitumit
- Tricosal® Elastomer®: rezistent ndaj shformimeve të mëdha të fugave, presionit të madh të ujit, temperaturave të ulëta, rezistent ndaj bitumit

Lloje të tjera ujëndaluesish me përmasa dhe forma speciale, si edhe aksesorë mund të disponohen sipas kërkesës, në përputhje me kërkesat e projektit.

Vendbashkimet / Pjesët bashkuese:

Për saldimit dhe prerjeve në kantier të ujëndaluesve, ofrohen pajisje të posaçme.

Llojet e bashkimeve:

- Pjesë e sheshtë tërthore
- Pjesë e sheshtë vertikale
- Pjesë-T e sheshtë
- Pjesë-T vertikale
- Pjesë-L e sheshtë
- Pjesë qoshe vertikale (kunjat brenda ose jashtë)

Magazinimi

Kushtet e magazinimit / Jetëgjatësia

60 muaj nga data e prodhimit, nëse ruhet në ambalazhin fillestar, të pahapur, të padëmtuar dhe të mbyllur, në kushte të thata dhe në temperatura që nuk i kalojnë 30°C. Mbrojeni nga rrezatimi UV.

Të dhënat teknike

Baza kimike Polivinil kloridi i plastifikuar (PVC-p)

Dendësia ~ 1.4 g/cm³ (± 0.1 g/cm³)

Temperatura e shërbimit -35°C deri në +55°C

Të dhënat fizike/ mekanike

Rezistenca ndaj tërheqjes	$\geq 10 \text{ N/mm}^2$	(EN ISO 527)
Fortësia Shore A	70 ± 5	(DIN 53505)
Zgjatimi deri në thyerje	$\geq 300\%$	(EN ISO 527)

Rezistenca

Rezistenca kimike	E përhershme:	Ujë, ujë deti dhe ujëra të zeza në temperaturë +23°C
	E përkohshme:	Alkale inorganike të tretura, acide dhe karburante minerale

Informacione mbi sistemin

Udhëzime aplikimi

Metoda e aplikimit / Mjetet

Ujëndalues (Waterbars) të vendosur në qendër:

Instalim sipas aksit në qendër të strukturës së betonit. Përshatje e lehtë e Sika®-Waterbars mbi armatura me fashëza të posaçme Sika®-Waterbar Clips (5 copë për m').

Ujëndalues (Waterbars) Sipërfaqësor:

Instalim në sipërfaqe të armaturës (kallëpit) ose mbi sipërfaqen e bazamentit apo të betonit të varfër.

Tipet e fugave përfundimtare:

Instalimi kryhet duke shtypur mbi armaturen e dërrasës ose përgjatë fugës.

Ngjitja (Saldimi):

Sika®-Waterbars Yellow janë prej PVC-je plastike, mund të saldohen lehtësisht në të nxehtë. Stabilizoni skajet fundore me format e posaçme Sika® Waterbar Welding Forms (të disponueshme për çdo lloj tipi) dhe nxehini ato me hekurin e përshatshëm për ngjitje Sika® Waterbar Splicing Iron Type 127 ose 126, derisa të shfaqet një pjesë e shkrirë e PVC-së. Më pas hiqni pajisjen e ngjitjes dhe presojini menjëherë fort midis tyre skajet e Waterbars që janë nxehur.

Temperatura e saldimit është ~ +200°C.

Shënime aplikimi / Kufizime

Në rast presioni negativ të ujit nuk mund të përdoren ujëndaluesit sipërfaqësor.

Baza e vlerave të matshme

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

Kufizime lokale

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për përshkrimin e saktë të fushave të aplikimit.

Informacione mbi shëndetin dhe sigurinë

Ky produkt është një objekt i nenit 3 të rregullores (KE) Nr.

1907/2006 (REACH). Nuk përmban substanca që parashikohet të çlirohen nga objekti në kushte përdorimi normale ose të parashikueshme. Nuk kërkohet fletë me të dhënat e sigurisë sipas nenit 3 të së njëjtës rregulloreje për të disponuar produktin në treg, transportuar apo përdorur atë. Për përdorim të sigurt ndiqni udhëzimet që jepen në këtë fletë me të dhënat e produktit.

Duke u bazuar me njohuritë tona aktuale, ky produkt nuk përmban SVHC (substances of very high concern, substancë me rrezikshmëri të lartë) siç klasifikohen në Aneksin XIV të rregullores REACH apo në listen e substancave candidate të publikuar nga Agjencia Europiane e Produkteve Kimike në përqëndrime më të mëdha se 0.1 % për peshë.

Shënime ligjore

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla sa që asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdolloj afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdolloj formë tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porositë pranohen sipas të gjitha kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit.



Sika Albania SHPK
Rruga Ibrahim Rugova,
Sky Tower, Building no. 5,
9th floor, Office 91,
Tirana, Albania.

Tel.: +355 4 454 0070
Email: info@al.sika.com
alb.sika.com